

11 10.01.10

8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
Sekretar i Përgjithshëm

Nr. ~~16~~¹³/Prot.
12

Tiranë, më 06/01/2011

Lënda: Dërgohet raporti final mbi auditimin e ushtruar në Komitetin Olimpik Shqiptar

Drejtuar: Z.Stavri BELLO


Sekretar i Përgjithshëm

TIRANË

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.69, datë 29.09.2010 "Për miratimin e manualit Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", kapitulli IV, pika 4.5, "Raportimi dhe komunikimi i auditimit, sigurimi i cilësisë së punës", bashkëngjitur po ju dërgojmë raportin final mbi auditin në "Komitetin Olimpik Shqiptar", Tiranë

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

BASHKIM SHEHU



RAPORT FINAL

I mbajtur në datë 06.01.2010, nga inspektori i auditit në MTKRS znj. Merita Gjoka, mbi auditin e ushtruar për periudhën 01.01.2008-30.09.2010.

Auditimi është kryer në zbatim të programit të auditimit nr. 7673, datë 29.10.2010 të miratuar nga Titullari i MTKRS.

Auditimi u përqendrua në auditimin e të planifikimit dhe kryerjen e pagesave të pagave si dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Auditimi ka filluar më datë 28.10.2010 dhe ka mbaruar më datë 10.11.2010, gjithsej 10 ditë ditë pune dhe kosto 24.545 lekë.

Raporti final u hartua duke u mbështetur në projektraport, observacionet e paraqitura nga personat përgjegjës dhe në takimin pajtues që u zhvillua në MTKRS më datë 06.01.2011. (Projektraporti i mbajtur më datë 10.11.2010 është dërguar me shkresën nr.7673/1, datë 17.11.2010 dhe i firmosur nga KOKSH me nr.8397 prot., datë 02.12.2010. Pranë drejtorisë së auditit është dorëzuar më datë 17.12.2010 znj. Merita Gjoka prej datës 15.12-31.12.2010 ka qenë me raport shëndetësor)

Inspektori i auditit për problemet e trajtuara, reflektoi si më poshtë:

Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë në planifikimin e fondit të pagave

Në mbështetje të ligjit nr. 8379, datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë" me ndryshime dhe ligjeve përkatëse të buxhetit për cdo vit, nga ana e KOSH është dërguar projekt buxheti në të cilën është paraqitur vetëm fondi i pagave sipas strukturave të miratuar në bazë të VKM nr.20, datë 24.01.1994 "Për ndarjen e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe krijimin e strukturës shtetërore të edukimit Fizik dhe Sporteve", i ndryshuar. Për çdo vit planifikimi i fondit të pagave është dërguar me shkresat, si më poshtë:

- për vitin 2008 me shkresën nr.160/07, datë 31.07.2007,
- për vitin 2009 me shkresën nr. 239, datë 05.08.2008, dhe
- për vitin 2010 me shkresën nr. 246, datë 29.07.2009.

Auditim mbi zbatimin e strukturës së institucionit lidhur me:

- Procedurat për lidhjen e kontratave të punës dhe zgjidhjen e tyre;
- Verifikimin e dosjeve personale dhe procedurave të ndjekura për rekrutimin e punonjësve;
- Përputhshmërinë e përshkrimit të pozicionit të punës me pozicionet e punonjësve;

Nga auditimi i procedurave të rekrutimit të punonjësve dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës është konstatuar se janë në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë", me ndryshimet, VKM nr.20, datë 24.01.1994 "Për ndarjen e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe krijimin e strukturës shtetërore të edukimit Fizik dhe Sporteve", i ndryshuar.

Me të gjithë punonjësit është lidhur kontratë në zbatim të ligjeve të mësipërme.

Në pozicionin e specialistit në 23 tetor 2008 ka shkëputur marrëdhëniet znj.Dena Grillo dhe është lidhur kontratë me znj.Juliana Kapllanaj në të njëjtën pozicion.

Nga verifikimi i dosjeve personale ato ishin të plotësuar me të gjitha të dhënat personale konform VKM nr.355, datë 07.07.2000 "Për organizimin e dosjes së regjistrit të personelit".

Të gjithë punonjësit kanë përputhshmëri të pozicionit të vendit të punës me arsimin dhe përgatitjen profesionale, të pajisur me diplomën dhe dëshmitë përkatëse.

Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë në pagesat e pagave, fondi i veçantë dhe sigurimet shoqërore, kontabilizimi i tyre.

Numri i punonjësve të KOSH-it, është përcaktuar dhe miratuar me VKM nr.20, datë 24.01.1994 "Për ndarjen e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe krijimin e strukturës shtetërore të edukimit Fizik dhe Sporteve", i ndryshuar.

Fondi i pagave është i planifikuar për pesë nënpunës me arsim të lartë të cilët paguhet sipas kategorive përkatëse (titullari me II-b, 1 përgjegjës sektori me III-b dhe 3 specialistë me IV-a) dhe një punonjës me arsim të mesëm, i cili paguhet me klasë.

Për periudhën që auditohet, realizimi i planit të buxhetit (vetëm për fondin e pagave dhe sigurimet) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme, në mijë lekë:

2008				2009			9- mujori2010		
Art.	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
600	4.598	4.107	89	4.987	4.771	96	4.050	4.044	100
601	863	791	92	759	759	100	545	517	95
Totali	5.461	4.898	90	5.746	5.530	96	4.595	4.561	99

Për të gjithë periudhën që auditohet pagat janë kryer në zbatim të VKM-ve të pagave ku janë të pasqyruar të gjitha ndryshimet e pagave dhe llogaritjet e sigurime shoqërore dhe shëndetësore sipas periudhave si më poshtë:

Për periudhën **Janar-Korrik 2008** personeli është paguar në mbështetje të VKM nr.478, datë 18.07.2007 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nënpunësve të disa institucioneve, në varësi të Ministrave të linjës", Lidhja 2. dhe me VKM nr.477, datë.13.07.2007 "Për disa ndryshime në vendimin nr.726 dt.21.12.2000 " Për pagat e punonjsve të institucioneve buxhetore" të ndryshuar,



Lidhja II-M, Klasa V.

Për periudhën **Korrik 2008-Prill 2009** personeli është paguar në mbështetje të VKM nr.1000, datë.02.07.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.478 datë.18.07.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Ministrive të linjës", të ndryshuar, Lidhja 2.

dhe me VKM nr.1231, datë 02.07.2008 "Për pagat e punonjësve mbështetës, në institucionet buxhetore dhe të nëpunësve në disa institucione buxhetore" Lidhja I, Klasa V.

Për periudhën **Maj 2009-Qershor 2010** personeli është paguar në mbështetje të VKM nr.606, datë 27.04.2009 "Disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.478, datë 18.07.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Ministrive të linjës", Lidhja 2.

dhe VKM nr.717, datë 23.06.2009 "Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" Lidhja I, Klasa V

Për periudhën **Korrik-Shtator 2010** pagat e punonjësve janë mbështetur në VKM nr.622, datë 08.07.2010 "Disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.478, datë 18.07.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Ministrive të linjës", të ndryshuar Lidhja 2.

Sigurimet shoqërore janë llogaritur në bazë të ligjit nr 7703, datë 21.05.1993 "Për sigurimet shoqërore e shtetërore". Nga auditimi i kryerjes së pagesave dhe mbajtjes së sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore u konstatua se janë pasqyruar të gjitha ndryshimet të nivelit të % së sigurimeve dhe të zbatimit të pagës maksimale mbi të cilën llogariten sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Këto llogaritje janë bërë në përputhje me VKM të nxjerra në zbatim të ligjit të mësipërm.

Konform Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1996 "Mbi tatimin mbi të ardhurat personale" janë llogaritur dhe mbajtur tatimi i pagës i cili është derdhur në shtet.

Për vitin 2008, në përputhje me VKM nr.369, datë 13.06.2007 "Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore" fondi i vecantë është përdorur në shumën 228.611 lekë dhe në masën 4.97 % mbi fondin e planifikuar të pagave.

Përdorimi i fondit të vecantë është bërë me urdhër të titullarit nr.307, datë 19.12.2008 me motivacionin shpërblim për punë të mirë, pika 2 dhe 3 e VKM së sipërcituar dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.21, datë 18.09.2007 "Për zbatimin e VKM nr.369, datë 13.06.2007"

Për vitin 2009 planifikimi dhe përdorimi i fondit të veçantë është audituar me programin nr.3505, datë 05.05.2010, për të cilin është mbajtur akt-verifikim më datë 06.05.2010 nga ku ka rezultuar se ky fond është përdorur në masën 3.8% të fondit të pagave në përputhje me VKM nr.369, datë 13.06.2007 "Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore" dhe udhëzimeve në zbatim të saj.

Për vitin 2010 nuk është kryer asnjë pagesë për shpërblimin e punonjësve nga fondi i veçantë në përputhje me VKM nr.591, datë 23.07.2010 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore".

Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.

KOSH e ushtron veprimtarinë e tij në zbatim të Kreut IV, ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin", i ndryshuar dhe VKM nr.20, datë 24.01.1994 "Për ndarjen e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe krijimin e strukturës shtetërore të edukimit Fizik dhe Sporteve", i ndryshuar.

Në nenin 11, pika 1 të ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin" i ndryshuar, është përcaktuar se KOSH e ushtron veprimtarinë në mbështetje të Kartës Olimpike dhe në përputhje me statutin e tij, të miratuar nga Ministri MTKRS. Nga auditimi u konstatua se KOSH nuk ka statut të miratuar nga Ministri i MTKRS, por vetëm nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar më datë 30.03.2002.

KOSH ka dërguar statutin e Tij me shkresën nr.148/05, datë 20.10.2005, por deri në këtë moment nuk është i miratuar.

Drejtoria e Sporteve në MTKRS në bashkëpunim me KOSH duhet të marrin të gjitha masat për miratimin e statudit të KOSH-it.

-Në takimin pajtues të mbajtur më datë 06.01.2011, Sekretari i Përgjithshëm paraqiti edhe njëherë statutin e mësipërm të dërguar në MTKRS. Nga Sekretari i Përgjithshëm i KOSH u paraqit argumenti që ky Statut po rishikohet dhe së shpejti do të paraqitet pranë MTKRS për miratim. Argumentim i cili u pranua edhe nga Drejtori i Sporteve në MTKRS ku u shpreh parimisht dakort për paraqitjen në një kohë sa më të shkurtër për miratim pranë Titullarit të MTKRS pasi të dorëzohet në MTKRS.

-Gjithashtu në këtë takim u paraqitën edhe njëherë pretendimet në lidhje emrin e këtij institucioni ku në VKM nr.20, datë 24.01.1994 "Për ndarjen e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe krijimin e strukturës shtetërore të edukimit Fizik dhe Sporteve", i ndryshuar ka emërtimin Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe në ligjin nr.9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin" ka emërtimin Komiteti Olimpik Shqiptar.

Gjatë auditimit u konstatua se KOSH në zbatim të Udhëzimit të MTKRS dhe MF nr.1, datë 08.02.2002 "Për mënyrën e financimit të cilësisë sportive", ka patur fond "Grant" të miratuar me Urdhër të Ministrit të MTKRS nr.203, datë 28.03.2008 "Për mbështetjen financiare të delegacionit sportiv pjesmarrës në Lojrat Olimpike Pekin 2008" në shumën 4.500.000 lekë së bashku me preventivin. Ky fond është përdorur sipas preventivit përkatës.

Kontabilizimi i veprimeve është bërë në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", është mbajtur kontabiliteti dhe janë përgatitur llogaritë vjetore. Llogaritë vjetore të pasqyruara në bilancin kontabël për vitet 2008-2009, janë pasqyruar vetëm të numrit të punonjësve dhe të fondit të pagave dhe për vitin 2008 është pasqyruar edhe fondi Grant. Në pasivin e bilancit janë të paraqitura detyrimet për tatim-taksa dhe sigurimet për muajin Dhjetor të vitit ushtrimor.

Bilancet janë të shoqëruara me relacionet përkatëse dhe të dorëzuara në MTKRS.

Këto ishin problemet e trajtuara në këtë raport. Për sa më sipër,
Në zbatim të nenit 18 dhe 21, të ligjit 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar rekomandojmë:

1-Në zbatim të nenit 11, pika 1 të ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin" i ndryshuar, të rishikojë Statutin e KOSH dhe të paraqitet pranë Titullarit të MTKRS për miratim dhe ta depozitojë në rregjistrin e organizatave jofitimprurëse në Gjykatën e Shkallës së Parë -Tiranë sipas procedurave të përcaktuara me ligj, brenda datës 30.06.2011.

2-Drejtoria e Sporteve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në MTKRS të pasqyrojnë ndryshimet në legjislacionin në fushën e sportit për të harmonizuar përputhshmërinë ndërmjet tyre, konkretisht:

-ligjit nr.9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin", i ndryshuar

-VKM nr.20, datë 24.01.1994 "Për ndarjen e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe krijimin e strukturës shtetërore të edukimit Fizik dhe Sporteve", i ndryshuar

Ky raport mbahet në dy kopje nga një për secilën palë.

Falenderojmë stafin e Komitetit Olimpik Shqiptar për vënien në dispozicion të dokumentacionit.

Inspektor i auditit

Merita GJOKA

